Oral History Kosovo

INTERVISTË ME KAMİLE TÜRBEDAR

Prishtinë | Data: 21 korrik, 2018
Kohëzgjatja: 50 minuta

Të pranishëm:

1. Kamile Türbedar (E intervistuara)
2. Ebru Süleyman (Intervistuesja)
3. Donjeta Berisha (Kamerë)

Simbolet e komenteve në transkriptë te komunikimi jo-verbal:
() - komunikim emocional
{} - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:
[ ] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin
Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Ebru Süleyman: A mundeni me na tregu emrin edhe mbiemrin?

Kamile Türbedar: Kamile Türbedar, mbiemri i bashkëshortit tim është Vıçıtırınli. Unë… babai im ka vdekur në luftë në të '41-tën. Unë u linda pasi që kishte vdekur babai, unë kam katër vëllezër, unë jam vajza e vetme. Babai im vdiq në luftë. Dikur jetonim në Mitrovicë, ata luftuan kundër gjermanëve dhe babai im vdiq në luftë. Shteti u kujdes shumë për ne.

Ebru Süleyman: Kur jeni lindur?

Kamile Türbedar: Unë u linda në të '41-tën. Unë nuk e njoha babain tim, nuk më kujtohet ai, por nëna na rriti. Ne të pestët u rritëm jetima. Ata u kujdesën për ne në çdo aspekt. Më pas nëna ime merrte dy pensione, një nga babai im pasi që ai vdiq në luftë, ajo e merrte pensionin e babait. A e din që dikur ka pasur shtesa për fëmijë? Andaj, ne jetonim mirë.

Ebru Süleyman: Ju ishit në Mitrovicë gjatë luftës në kohën kur babai juaj vdiq?

Kamile Türbedar: Jo, unë kam jetuar në Mitrovicë me babain… me nënën. Dhe më pas shkuam te Tyrbja, pas Tyrbes u kthyem në Prishtinë. Unë jam *türbedar* [roje të tyrbes], nëse e din varrin e Sulltan Muratit aty.

Ebru Süleyman: A mund të më tregosh më shumë, pse është familja juaj *türbedar,* roje të tyrbes?

Kamile Türbedar: Ka qenë familja Türbedar… unë i kam pasur tre axhë. Ata ishin tre vëllezër dhe dy motra, por ata kanë vdekur.

Ebru Süleyman: Ata kujdeseshin për tyrben?

Kamile Türbedar: Po, ata kujdeseshin për tyrben; gjyshja ime, gjyshi im kujdesej për tyrben, ishin roje të tyrbes. Tani gruaja e kushëririt kujdeset, një boshnjake kujdeset për tyrben, por gjyshja ime kryesisht është kujdesur për tyrben.

Ebru Süleyman: A të kujtohet gjyshja, gjyshi?

Kamile Türbedar: E tëra, jo gjyshi por gjyshja. Nuk e njoha gjyshin, por e njoha gjyshën. E njoha gjyshën, nuk më kujtohet babai pasi që unë u linda pas luftës. Ata [partizanët] morrën babain tim në luftë kundër gjermanëve dhe ai vdiq në betejë, unë u linda pas kësaj. Përndryshe, së pari më emëruan Shirin, më pas me qëllim të trashëgimit të babait tim, ata e kuptuan tre jave më vonë që ai kishe vdekur, dhe e ndërruan nga Çamil në Çamile dhe unë mbeta Kamile (qeshë). Kështu ishte.

Ebru Süleyman: Do të thotë, ju u lindët pas Luftës së Parë… Luftës së Dytë Botërore, ishte vështirë në atë kohë.

Kamile Türbedar: Po, jeta ishte e vështirë, por u kujdesën për ne. Ata na ftonin në komunë për drekë *Sedmi Juli* [7 korriku][1] quhej. Pastaj kur shkonim nga aty, por së pari na bënin drekë, i dhuronin lule nënës sime, ata kujdeseshin për ne. Nëna merrte dy pensione, një nga babai i cili ka vdekur në luftë… ajo na rriti. Pasi që ne nuk studiuam, njëri nga vëllezërit përfundoi gjimnazin, ai u bë operator në kinema, tjetri u bë vozitës, e njëjta ndodhi edhe me tjetrin, ai e bën këtë zanatin… Poashtu edhe unë zgjodha zanatin, u bëra floktare. Unë jam floktarja e parë në Prishtinë.

Ebru Süleyman: A të kujtohet… ?

Kamile Türbedar: Më kujtohet, kur fillova e kishim një *zadruga*[2], nuk e kishim asnjë mjeshtër, ai shkoi në Turqi. Ne të dyja, Lejla, gruaja e Sami Dulës dhe unë, dy floktare, studente, ishin bërë vetëm dy vjet që e mësonim zanatin. Andaj, unë dhe ajo u bëmë eksperte, ata e sollën një floktare nga Beogradi, sepse nuk kishte floktare në Prishtinë, ndoshta as në tërë Kosovën. Nuk kishte. Nuk bëhej kjo punë, rregullonin vetëm flokët e njerëzve të rëndësishëm, ashtu ishte.

Ebru Süleyman: Motra Kamile, a të kujtohet si ka qenë qyteti kur keni qenë fëmijë, çfarë keni bërë atëherë si fëmijë?

Kamile Türbedar: Kur ishim fëmijë…

Ebru Süleyman: Mahalla, fqinjët.

Kamile Türbedar: Mahalla, ne rrinim të zgjuar deri në *sahur*[3] të ramazanit. Pastaj binin tupanat, secili vraponte në shtëpi për të ngrënë *sahur*, sepse pastaj do të fillonim agjërimin. Ramazani ishte kështu, dikur përgaditnim iftarin. Përgaditnin *mazdure*[4], e ftonim njëri-tjetrin në iftar, tash iftarët nuk janë më, bota ka ndryshuar, është ndryshe.

---

[1] 7 korriku, është datë historike e cila shënjon Kryengritjen e Popullit të Serbisë, kjo ishte ditë feste në Republikën Socialiste të Jugosllavisë, më vonë edhe në Republikën e Serbisë dhe është festuar nga viti 1945-2001.
[2] Serb.: *zadruga*, dyqan, mirëpo folësja e përdor t'i referohet Shoqatës së floktarëve.
[3] Ushqim që hahet para fillimit të agjërimit të ramazanit.
[4] Ushqim që gatuhet me drithëra dhe jogurt.

Ebru Süleyman: Atëherë lumi ka qenë i hapur apo?

Kamile Türbedar: Lumenjtë, po. Prishtevka rrjedhte para teatrit, ashtu ishte.

Ebru Süleyman: Pastaj qyteti filloi të ndryshojë.

Kamile Türbedar: Të ndryshojë, natyrisht që ndryshoi. Shumëçka ndryshoi në Prishtinë. Ishte ndryshe. Atëherë ishte… ka qenë në një mënyrë, tash është në një mënyrë tjetër. E kanë rregulluar, qendra është rregulluar. Në këtë kohë ishte [Hotel] "Unioni", "Grandi". "Grandi" u ndërtua më vonë. Ky, ky hoteli pranë teatrit, a quhej "Beogradska"?

Ebru Süleyman: Ndoshta "Bozhuri"?

Kamile Türbedar: "Bozhuri". "Bozhuri". "Bozhuri" ishte më i vjetri. Dikur e kalonim Vitin e Ri aty. Vitin e Ri, po.

Ebru Süleyman: Dhe… kush ka jetuar në Prishtinë, cilat gjuhë i keni dëgjuar nëpër rrugë?

Kamile Türbedar: Ta them të vërtetën, gjuha turke është dëgjuar shumë. Më pas shumë prej tyre migruan në Turqi. Filloi…

Ebru Süleyman: A të kujtohen këto migrime?

Kamile Türbedar: Më kujtohen, natyrisht që po. Nga familja jonë, të dyja tezet janë në Turqi. Ato na i dërguan neve dokumentet për të migruar. Nëna ime e konsideronte këtë, edhe pse qëndronte këtu dhe merrte dy pensione. Çfarë do të mund të bënte ajo atje? Dokumentet skaduan dhe ne nuk shkuam. Nëna ime merrte dy pensione, një pse babi im kishte vdekur në luftë, pensionin e tij. Ajo merrte edhe shtesat për fëmijë, dikur na i jipnin ato. Ne jetonim mirë.

Ebru Süleyman: Pra tezet e juaja shkuan?

Kamile Türbedar: Tezet e mija u larguan herët, nuk i njoh sepse ato e lanë nënën time në Vushtrri dhe migruan nga aty.

Ebru Süleyman: Ato u larguan pas Luftës së Dytë Botërore, apo?

Kamile Türbedar: Po. Po, ato jo. Nuk e di. Herën e parë shkuan, ato shkuan gjatë Luftës së Parë. Në Luftën e Parë ato migruan atje, ato, te dyja motrat dëshironin dokumente për vëllezërit e tyre. Nëna ime qëndroi. Pastaj ajo u martua këtu. Nëna ime është nga Vushtrria, nga familja Macun, vajza e Şevçet

Aga. Ai ishte shumë i pasur, Gojbulja ishte fshati i tyre. Ai ishte i pasur. Ne dikur, aty ishte një fshat serb, fshatarët punonin për të, kujdeseshin për fëmijët sepse ata ishin nga fshati i tij, mjelnin lopët. Nëna ime ka qenë vajza e një njeriu të pasur. Nuk e mbajë në mend pasurinë e babait tim, sepse ne ishim jetim, ashtu ishte…

Ebru Süleyman: Përveç turqishtes…

Kamile Türbedar: Unë e njoh gjuhën serbe, shqipe, dhe serbe. Pak gjermanisht, atëherë në shkollë mësonim gjermanisht. Nuk kishte anglisht në shkollë, gjermanisht dhe turqisht. Kjo ishte! Süreyya ka qenë drejtoreshë e turqve.

Ebru Süleyman: Süreyya Yusuf.

Kamile Türbedar: Tani Alia e Elma Aksoy, ai ishte aty para saj, tani Süreyya. Ata migruan për në Turqi, Elma Aksoy prezantuesja e lajmeve. Ata shkuan në Turqi, pastaj Süreyya u bë drejtoreshë. Kështu unë kam përfunduar tetë-vjeçaren. Unë e mësova këtë zanat, jam e lumtur për këtë. Në atë kohë gati se nuk kishte floktare, ne ishim të vetmet. Mjeshtri kishte shkuar në Turqi, ne kishim mbetur pa zanatli. Më pas një grua nga Beogradi erdhi, ajo na mësoi, mua dhe Lejlën. Dhe kështu u bëmë floktare…

Ebru Süleyman: Si erdhi ajo gruaja nga Beogradi?

Kamile Türbedar: Ata shkuan dhe e morën ate në Beograd. Ajo punonte atje, ata kërkuan nga ajo të vijë dhe ajo erdhi. Ajo kishte dy fëmijë atje.

Ebru Süleyman: Shteti e solli këtu?

Kamile Türbedar: Jo, ne… po, shteti. Ne kishim mbetur pa zanatli. Ai shkoi në Turqi dhe ne mbetëm, pastaj ajo na mësoi mirë. Dhe po të tregojë, ne kishim shtet, ata na dërgonin secilin në trajnime për një muaj në Beograd. një vit na dërguan në Suboticë, pastaj në Beograd për të mësuar zanatin. Si t'i pregadisim ato kemikaljet dhe të tjera. Herën e fundit isha atje për 20 ditë. Djali im shkonte në ushtri; mua m'u desh të kthehesha dy ditë më herët. Ata ma dërguan diplomën time. Unë u ktheva më herët sepse djali më shkonte në ushtri. Ditën kur ata janë dashur t'ia dorëzojnë shtafetën Titos, por nuk ia kanë dorëzuar, nuk ia kanë dorëzuar shtafetën. Unë sapo arrita, një grua më tha, "E sheh çfarë bëjnë këta shqiptarët?" Thashë, "Çka po di unë?!"

Ebru Süleyman: Pse nuk e kanë dorëzuar? Çka është shtafeta?

Kamile Türbedar: Nuk e di, serbët, shqiptarët, nuk lejuan që shtafeta të dorëzohej. Unë nuk e di, sapo isha kthyer nga Beogradi. Më pas i thashë, "Nuk e di, sapo erdha nga Beogradi". Ajo e dinte që unë jam

turke; ajo mendoi se do të më bëj të flas kundër shqiptarëve. Çfarë kisha unë për të thënë? I thashë, "*Ne znam šta se radi ovde*" [Nuk e di çka po ndodh këtu]. Kështu ishte.

Ebru Süleyman: Atëherë, i tërë qyteti vinte tek ti për t'ia rregulluar flokët?

Kamile Türbedar: Atëherë, po, nuk kishte floktare tjera. Fillimisht e rregullova Pepicën, flokët dhe thonjtë e gruas së Kardelit. Më pas, Jovankën, e cila erdhi dy herë. Njëherë në Brezovicë, pastaj këtu.

Ebru Süleyman: A të kujtohet në cilin vit?

Kamile Türbedar: Ta them të vërtetën, nuk më kujtohet tash, unë punoja për Shoqatën e Floktarëve, isha e re, rregullova flokët e Jovankës dhe ajo tha, "Ti më i rregullove më mirë se flokëtarja ime". Unë dija si t'i bëja ato punxhat. Atëherë ishin në modë. Stilet e flokëve kishin emra, emra të ndryshëm. *Lokna, pletenica, šestica* [dredha, gërsheta, gjashqe]; poashtu edhe stilet e flokëve të drejta: *pas, mačkica* [qeni, maca]. Më pas ishin edhe këto stilet tjera si *slobodna frizura* [stil i lirë i flokëve], tash këto nuk kanë emër, asgjë. Dikur na dërgonin në Beograd të mësoheshim, tash asgjë. Çkado që mësoje nga zanatlia, poqëse e mësove keq edhe do të duket keq, varet se si mëson. Edhe në shkollë, nëse mësuesi është i mirë, ai edhe të mëson mirë. Ashtu ishte. Ajo ishte nga Beogradi, dhe kështu. Tani një flokëtar privat u hap. Flokëtar Ilazi, Prishtina u rritë, u mbush me flokëtar.

Ebru Süleyman: Jovanka erdhi në Brezovicë herën e dytë?

Kamile Türbedar: Herën e dytë në Brezovicë, më pas shkuan në Gjilan, më morën me veti, flejta atje. Pastaj në mëngjes u ktheva me ta. Ata shkuan në Gjilan në tepiha, në fabrikë të tepihave. Shkuan, perde, tepiha [fabrika]. Ata shkuan dhe më kthyen mua këtu, kështu ishte.

Ebru Süleyman: Dhe tani, përveç Jovankës, ti rregulloje flokët e shumë njerëzve tjerë, apo?

Kamile Türbedar: Para Jovankës, Pepica Kardelj, tani Jovanka. Gruas së Mahmut Bakallit, Xhavit Nimanit, Ilaz Kurteshit, Fadil Hoxhës. Flokët e saj ishin natyrale, vetëm ia preja, ajo vinte në oborr në shtëpinë time dhe unë vetëm ia preja, ishte e qetë. Madje vinin edhe nga Beogradi që unë t'ua rregulloja flokët.

Ebru Süleyman: Kush i kishte flokët më të mira?

Kamile Türbedar: Flokët e Vahides ishin të mira, natyrale. Pastaj gruaja e Ilaz Kurteshit. Shumë prej tyre u bëja frizura. Ai që u bë president pas Titos… dikur rregulloja edhe flokët e tij. Vetëm para disa ditëve vajza e tij ishte, ia rregullova flokët. Vajza e tij. Ajo tha, "Hej, a e din që ata flasin serbisht me mua?" Nëna e saj dikur fliste [serbisht]. Ajo thoshte, "Ne jemi shqiptarë, ne vetëm e flasim gjuhën [serbe]". Ajo anë, fshati i tyre flet shqip, sepse Ilaz Kurteshi ka folur turqisht… jo, shqip me mua.

Kështu… rregulloja flokët e Emel Sayın. Më lejoni t'u tregojë, të Mahmutit, Ilaz Kurteshit, Xhavit Nimanit, Asllan Fazlisë, kështu, njerëzve të Komitetit.

Ebru Süleyman: Pse Emel Sayın vinte këtu, ndoshta për koncert?

Kamile Türbedar: Ajo erdhi dhe këndoi, në "Grand", aty ia rregullova flokët. Ajo poashtu erdhi në televizion, e inçizuam. Më pas ishin edhe katër tjera, por nuk më kujtohet kush ishin… rregullova flokët e Erol Büyükburç, ai erdhi me gruan e dytë, me Emel; rregullova flokët e saj, e kështu. Poashtu, kam bërë grim, kështu si grimere. Kur filloi televizioni më ftuan të punojë aty, dhe unë shkova. U pensionova nga aty, sepse punoja në të dyjat edhe këtu në dyqan edhe atje. Më pas e braktisa, erdha këtu të punojë dhe punova në televizion derisa u pensionova. U largova kur isha 60, kur serbët e morën televizionin. Atëherë u largova.

Ebru Süleyman: Kur ishte kjo, në të '90-tat?

Kamile Türbedar: Nuk e di, kështu disi. Kur ata u larguan nga stacioni televiziv. Unë u pensionova, atëherë pensionoheshe me 60 vjet, por unë ende punoj. Kështu pra.

Ebru Süleyman: Sa ishe në televizion ua rregulloje flokët moderatorëve?

Kamile Türbedar: Prezantueseve të lajmeve, këngëtareve të cilat vinin nga Beogradi, Turqia. Siç të thashë, flokët e Emel Sayınit, gruas së Erol Büyükburç, gruas së dytë. Ajo poashtu quhet Emel. Ajo kishte flokë natyrale, unë vetëm i bëja pak grim dhe ia vëja ca xixa në flokë, dhe kjo ishte e tëra.

Ebru Süleyman: Pra, motra Kamile, e ke vërejtur këto vite si kanë ndryshuar gjërat dhe si moda ka ndryshuar, muzika ka ndryshuar, qyteti ka ndryshuar, çdo gjë ka ndryshuar. A të kujtohet si erdhi deri te këto ndryshime? A të kujtohet kur është hapur kinemaja e parë? Kur televizionet e para erdhën, kur gjërat e reja erdhën, risitë e kohës?

Kamile Türbedar: Televizioni u hap në të '60-tat, më 1960. Më pas më thirrën në televizion, e lashë punëtorën vetëm, unë punoja këtu në dyqan. Shumë shpesh më duhej t'i braktisja myshteritë dhe të shkoja, deri në 14:00. Shkoja në televizion pas orës 14:00. Këngëtaret, kushdo që vinte aty, rregulloja flokët e këngëtareve dhe moderatoreve. Ua vendosja pudrën që fytyra të mos iu shkëlqente.

Ebru Süleyman: A të kujtohet kur kinemaja e parë është hapur, cilët filma vinin?

Kamile Türbedar: Kryesisht ata filmat me kauboj vinin këtu, vëllau im ishte projeksionist i filmit dhe ai i lëshonte filmat. Këtu në "*Omladina*" [Kino Rinia]. Aty. Nuk e di se në cilin vit, kam harruar, atëherë ende isha vajzë e re. Ne shkonim shumë në kinema. Ndonjëherë shkoja aty ku vëllau i projeksiononte filmat, shkonim aty edhe me nusën e tij. Kështu pra.

Ebru Süleyman: A shkonit edhe në Gërmi poashtu?

Kamile Türbedar: Po, shkonim edhe në Gërmi për piknik natyrisht. Shkonim të dielave, atëherë nuk kishte hotel aty, ne shkonim aty. Aty lartë ishte një hotel ku ftoheshin menaxherët për dreka; ata vinin nga jashtë. Por nuk ishte këtu atëherë, ishte ndërtuar më vonë. Atëherë shkonim në Gërmi në piknik. Merrnim me veti saçin ku pjeknim pitet. A më kupton?

Ebru Süleyman: Po, po flija…

Kamile Türbedar: Dikur pjeknim flija aty. Jo pite, por flija. Ndeznim zjarrin, flija. Me defa, i mshonim defit, këndonim. Ishte një Magbule Hovarda, shumë e shoqërueshme, ajo në njërën anë, ne në tjetrën këndonim, o Zot, o Zot! Kështu… poashtu ishte Nazmiye Goleşka, ajo i mëshonte defit. Merrnim me veti jambolija dhe me saça me veti pjeknim flija, hanim aty dhe ktheheshim natën.

Ebru Süleyman: Me kënd shkoje aty?

Kamile Türbedar: Të gjitha ishim gra, s'kishte të rinjë. Gra të moshuara, merrnim fëmijët tonë me veti dhe kështu ishte. Ishte një atmosferë më ndryshe. Tash askush s'e njeh askend. Tash as nuk pranojmë aq shumë mysafirë. Atëherë kishim edhe zbavitje mëngjesi. Në mëngjes, atëherë vendosnim hena për Shën Gjergj. Atëherë secila vendoste diçka.

Ebru Süleyman: Çka është ajo?

Kamile Türbedar: Martifal[5]. Dikush këndonte *māni* [këngë folklorike], mbulonim fytrën e saj me shami të kuqe. Ajo vendoste dorën në tenxhere. Ajo e vënte duart e saj në *qymlek* [ibrik]. *Qymlek* qëndronte nën trëndafila tërë natën. Secili vënte diçka në të, çfarëdo që dëshironin. Më vonë, ajo vajzë e veshur me një shall të kuq merrte gjërat jashtë nga *qymlek* dhe i mbante ato. Dikush do të këndonte një *māni*. Pastaj do të pyeste, "E kujt është kjo?" Dikush do të thoshte, "Është e imja". Kështu që ata do të këndonin *māni*.

Ebru Süleyman: Kjo për Shën Gjergj?

[5] *Martifal* është një traditë e turqëve nomadik të Anatolisë dhe e turqëve të Maqedonisë dhe Kosovës. Në pasditën e 5 majit, vajzat e reja të komunitetit turk bartin një enë dheu nga dera në derë dhe kërkojnë nga gratë të vendosin gjësendet e tyre (unaza, vath, etj) në të përderisa e mendojnë një dëshrë. Kështu që, ena është e mbushur me ujë dhe me lule dhe erëza. Në fund ena vendoset në një varg të trëndafilave dhe mbulohen me një material. Në mëngjesin e Shen Gjergjit, gratë mblidhen dhe e sjellin enën, pastaj një vajzë e re fillon t'i nxjerrë gjësendet nga ena, përderisa gratë e pranishme këndojnë poezi *māni*.

Kamile Türbedar: Po, për Shën Gjergj, ne e vendosnim një *qymlek* gjatë gjithë natës nën trëndafila. Secili nga mahalla vënte disa sende, të nesërmen, *martifal*. Gatuanim llokuma për të ngrënë. Ato kopshte të mëdha… ishte një atmosferë tjetër… kojshitë… çdo mahallë bënte *martifal.*

Ebru Süleyman: Unë kam ndëgjuar që për Shën Gjergj, poashtu është ndezur zjarri?

Kamile Türbedar: Dikur zjarrin e ndeznim në Gërmi. Ndeznim zjarrin dhe pjeknim flia aty, kështu ishte.

Ebru Süleyman: E çka bënit për Vitin e Ri?

Kamile Türbedar: Ne nuk e festonim Vitin e Ri aq shumë, nuk ishte shumë me rëndësi.

Ebru Süleyman: Ndoshta Bajramin?

Kamile Türbedar: Po, ne e festonim Bajramin. Për Bajram nëna ime pastronte tërë natën; fustanat i qepnim, ishte një atmosferë krejt tjetër. Tani për ramazan, ne qëndronim jashtë deri në 12:00 të natës dhe tani kur i binin tupanit për *sahur*, të gjithë vraponim në shtëpi… *A e kom kto?* [Në shqip]… kur i binin tupanit për *sahur*, të gjithë ne shkonim të hajmë *sahur* dhe në gjumë. Atëherë flenim më gjatë në mëngjes. Ishte një atmosferë krejt tjetër.

Ebru Süleyman: Çfarë punonin njerëzit atëherë, ndoshta zanate më shumë?

Kamile Türbedar: Më shumë zanate. Nuk kishte, shkollat ishin të pakta, jo secili shkonte në shkollë apo diplomonte nga tetë-vjeçarja. Sikurse unë, unë i bëra tetë vjet shkollë dhe tani më dërguan në zanat. Vëllau im u bë projeksionist i kinemasë, tjetri shofer. Sidoqoftë, ata donin të na edukonin, por ne të gjithë zgjodhëm zanatin. Njëri prej tyre punon fshisa elektrike, siç thashë njëri është shofer. Nuk e di kështu ishte.

Ebru Süleyman: Ndërsa, atëherë kur fabrikat punonin?

Kamile Türbedar: Dikur ishte një mulli dhe fabrika e qumështit, nuk kishte asgjë tjetër. Poashtu shkolla e zanatit, ku mësohej si të qepeshin fustanat, palltot, gjëra, rrobaqepësi. Nuk kishte asgjë tjetër. Kishte një mulli, u mbyll, fabrika e qumështit u mbyll, tani nuk kemi fabrika tjera.

Ebru Süleyman: Kur ke shkuar në shkollë tetë-vjeçare, a ka ekzistuar edukimi në turqisht?

Kamile Türbedar: Po.

Ebru Süleyman: Pra, kjo është pas 1957.

Kamile Türbedar: Babai i Elma Aksoy, tani Süreyya. Elma Aksoy shkoi.

Ebru Süleyman: Kur kanë fillu shkollat në turqisht?

Kamile Türbedar: Erdhën këtu dhe na morën, "Ti flet turqisht. Eja në shkollë turke", ashtu ishte.

Ebru Süleyman: Këtu në "Elena Gjika"?

Kamile Türbedar: Po, në "Elena Gjika", tani më vonë në "Meto Bajraktari". Kështu… tani edhe vëllau im është arsimuar në turqisht, unë poashtu.

Ebru Süleyman: Kush ishin mësuesit tu, a të kujtohet?

Kamile Türbedar: Babai i Elma Aksoyit, ai ishte njëri prej tyre. Tani Süreyya, burri i Fitnetit, babai i Tanerit.

Ebru Süleyman: Süreyya Yusuf.

Kamile Türbedar: Po, pas atij ishte gruaja e Ali Ümer, ajo na mësonte amvisëri, aty mësoje rrobaqepësi, a e kupton? Punë me krrabëza, qëndisje, ekzistonte.

Ebru Süleyman: Ju kishit këtë lloj kursi?

Kamile Türbedar: Këto kurse, pastaj diplomova, shkova në zanate, gjeta zanatin tim, kështu ishte.

Ebru Süleyman: Më pas, kur punoje këtu, ku të gjithë ishin nga qyteti, në një kohë kur të gjithë rregullonin flokët e tyre; ata kanë bërë muhabet dhe kanë folur me ty shumë gjëra. Ndoshta e ke ditur çfarë po ndodhte [në qytet] më shumë se të tjerët?

Kamile Türbedar: Po, e vërtetë. Dikur thonin që në hamam dhe te flokëtari kuptohen të gjitha gjërat. Pastaj gratë vinin, njëra tregon diçka, tjetra diçka tjetër; nuk ka pasur televizion në atë kohë.

Ebru Süleyman: Kur janë shfaqur televizionet?

Kamile Türbedar: Ta them të vërtetën, unë e bleva një dhe mund të them se e tërë mahalla vinte për të shikuar televizion.

Ebru Süleyman: Në shtëpi te ti?

Kamile Türbedar: Po, sepse vëllau im ishte mjeshtër i televizionit dhe më vonë edhe djali im. Dhe më pas e tërë mahalla vinte për të shikuar. Ishte sikur kinema në shtëpinë time. A mund të besosh, gratë uleshin aty lartë dhe të gjithë fëmijët i vënin këmbët nën televizion përderisa e shikonin. Nuk ka pasur të tjera në mahallën tonë. Ne e kishim të parët, tani të tjerët, tani Vehap Shita. Më pas mahalla u mbush me televizione, por ne e kemi pasur të parët.

Ebru Süleyman: Në atë kohë programet ishin vetëm në kohë të caktuara, apo? Natën.

Kamile Türbedar: Natën, pasdite, mëngjesi ishte për filma. Pasditja ishte për lajme dhe gjëra tjera, kështu ishte. Filmat në mëngjes.

Ebru Süleyman: A ju kanë mësuar serbisht, shqip, në shkollë, apo a keni mësuar nga këto qarqe?

Kamile Türbedar: Serbisht, serbisht, jo… serbisht. Ne kishim klasë në serbisht, jo në shqip. Serbisht, ne kishim serbisht tre orë në javë. Ne kishim serbisht dy orë në jave. Këtu e kishim Katica Popović, ajo ishte mësuese e serbishtës. Süreyya ishte drejtoreshë e "Meto Bajraktarit".

Ebru Süleyman: Më tregove që kur nuk keni pasur televizion atëherë, si i keni marrë informacionet?

Kamile Türbedar: E lëshonim radion, radion. Qamili i Vogël këndonte atëherë. Kishim një radio të vogël, e tërë mahalla vinte dhe e dëgjonte. Qamili i Vogël këndonte, "*Çu more Rexho dil te lana/ darsëm të madhe po të ban nana"* [Në shqip] këtë këngën. Gratë qanin, dhe unë i shikoja të gjitha. Unë isha fëmi, mendoja pse po qanin? Ai u vra natën kur ai është dashur të hyjë dhëndërr, a e kupton? Kali i kishte rënë dhe ai kishte vdekur. "*Çu more Rexho dil te lana/ darsëm të madhe po të ban nana"* [Në shqip] A po e kupton? Ai vdiq, po, këtë tregim e tregon. Ato gra e dëgjonin dhe qanin; në radion tonë të vogël. Vëllau im riparonte dhe i punonte radiot, ai e solli një dhe ne e dëgjonim. Gratë këndonin, mahalla i dëgjonte. Vetëm ne kishim radio. Kështu ishte, kishte varfëri. Vajza ime çfarë tjetër mund të të them…

Ebru Süleyman: Si ishte, kishte varfëri…

Kamile Türbedar: Nuk kishte asnjigjë, blenim bukë me kupona. Ishte një sistem tjetër. Ishte një sistem tjetër, po tregoj për pas luftën. Na jipnin edhe shtesa për fëmijë, kushdo që kishte fëmijë, ashtu ishte atëherë.

Ebru Süleyman: Kur ka filluar të bëhej më mirë?

Kamile Türbedar: Më pas ato kupona u zhdukën, kishte pasuri, u bë më mirë në kohën e Titos, ne përparuam.

Ebru Süleyman: Qyteti ndryshoi poashtu…

Kamile Türbedar: Natyrisht, ndryshoi, ashtu ishte.

Ebru Süleyman: A të kujtohet xhamia e cila ishte afër "Unionit" edhe kisha?

Kamile Türbedar: Natyrisht. Atë kishën e shkatërruan. Më kujtohet një fontanë me ujë, e cila u rishfaqë pranë teatrit. Po, Hashim, e quanim fontana e Hashim Haxhibajramit. I ka takuar Hashim Haxhibajramit. Ndoshta e kanë mbyllur dhe ia kanë marrë tokën. U rishfaqë pranë teatrit.

Ebru Süleyman: Motra Kamile, ju më thatë i njihni banorët e qytetit në bazë të mbiemrave.

Kamile Türbedar: Po.

Ebru Süleyman: Asokohe, të gjithë njiheshin me njëri-tjetrin, të gjitha familjet, të gjitha njihnin njëra tjetrën?

Kamile Türbedar: Ishin Şamli, ne Türbedar, Haciaguş, Sümçür, Maçka, Straya; ata të doktor İzzedinit poashtu janë Straya. Ishin shumë, por e dija nga mbiemri, si Maçka dhe të tjerët. Çeçi, nuk e di, por e ke ditur në bazë të mbiemrit.

Ebru Süleyman: Nga mbiemri dhe në bazë të vendit ku kanë jetuar në qytet.

Kamile Türbedar: Po, po, ashtu. Ata që vinin nga fshatrat, ata jetonin në periferi, sepse qendra e qytetit ishte… nuk kishte shumë… Prishtina nuk ishte qytet i madh atëherë.

Ebru Süleyman: Sa ishin? Sa kishte atëherë?

Kamile Türbedar: Atëherë kur Tauk Bahçe u ndërtua, ato shtëpitë, në atë anë nuk ka pasur asgjë më herët. Kishte shtëpi pas kishës. Ato nuk kanë ekzistuar. Vetëm deri te kisha [kishte shtëpi], tutje vetëm serbët jetonin andej. Pastaj qyteti u rrit, u bë më i madh.

Ebru Süleyman: Po ashtu Dragodani, ishte vetëm bashqe apo?

Kamile Türbedar: Në Dragodan, asgjë nuk ka pasur në Dragodan. Asnjigjë nuk ka qenë. Deri te binaret e trenit dhe tutje nuk ka pasur asnjigjë. Deri te stacioni i trenit kanë qenë romët, nuk kishte shtëpi aty, ato shtëpi erdhën më vonë.

Ebru Süleyman: A kanë jetuar aty romët?

Kamile Türbedar: Filluar nga lumi përgjatë tërë rrugës ka pasur romë, dhe me të kaluar binarët e trenit e drejt kah kodra, ato shtëpi të gjitha janë të reja.

Ebru Süleyman: Ato te varrezat?

Kamile Türbedar: Po, ato të gjitha janë shtëpi të reja. Ato janë shtëpi të reja. Prej trenit deri aty lartë, të gjitha janë të reja. Kështu... tash Prishtina është lidhur me Obiliç.

Ebru Süleyman: A të kujtohet nëse ka pasur familje hebreje që kanë mbetur pas Luftë së Dytë Botërore?

Kamile Türbedar: Ka qenë një hebrej Misini… Misin ishte emri i tij… Misini ka qenë drejtor apo diçka ashtu këtu, ai ka qenë njeri i rëndësishëm. Ai ishte hebrej dhe gruaja e tij ishte serbe. Dikur ajo i rregullonte flokët në sallonin tim. Tani ishte Sarina, ajo ishte me një turk, Sarina. Ajo grua hebreje mbeti, nuk e di të tjerë, por të gjithë shkuan. Ajo u martua me drejtorin tonë nga Shoqata e Flokëtarëve, Kadrinë. Më pas ishte ajo, ajo kishte një djal Nexhatin, ajo ishte këtu… por nuk ka pasur të tjerë, dhe Misini, askush tjetër… jo, në Prishtinë. Unë nuk di për vendet tjera. Ishte Misini dhe ai e kishte gruan serbe. Më pas më duket ai u bë kryetar komune apo kryetar i Komitetit. Misini ka qenë një njeri shumë i pashëm, gruaja e tij ka qenë arsimtare e gjuhës serbe në gjimnaz, Lubica. Ajo ka qenë e bukur. Kështu ka qenë, nuk di për tjerët. Ajo poashtu… gruaja e Kadrisë, drejtorit të Shoqatës së Floktarëve, ajo ka qenë hebreje. Nuk di për të tjerët. Të gjithë kanë ikur, kanë qenë ato dyqanet dhe ata kanë shitur ato figurinat dhe rruazat. Ne i mbledhnim ato dikur. I shkatërruan ato pjesë, ne fëmijët dikur i mbledhnim figurinat.

Ebru Süleyman: Cilat shtëpi?

Kamile Türbedar: I shkatërruan ato dyqane; ne gjetëm shumë figurina.

Ebru Süleyman: Në rrugën Divanjol?

Kamile Türbedar: Në Divanjol.

Ebru Süleyman: Çfarë figurina?

Kamile Türbedar: Figurina të zakonshme, rruaza.

Ebru Süleyman: Ato ishin nga dyqanet e shkatërruara të hebrejëve?

Kamile Türbedar: I shkatërruan dhe ne fëmijët i mblidhnim ato. Sidoqoftë, unë jam flokëtarja e parë në Prishtinë, ndoshta në Kosovë. E sollëm një flokëtare nga Beogradi, ajo na mësoi, pastaj ajo shkoi.

Më pas unë dhe Lejla ishin flokëtaret e para këtu. Mjeshtri ynë shkoi në Turqi, ne ishin flokëtare e para. Më pas me kohë, pas neve, ishin edhe studentet të cilat mësuan të tjerët, dhe kështi ishte.

Ebru Süleyman: U zhvillua nga ju të dyja?

Kamile Türbedar: Ashtu u zhvillua, ashtu.

Ebru Süleyman: Pra në atë kohë, në kohën e Jugosllavisë, si ishe jeta? A kishte… si ishte jeta për ata që punonin për partinë dhe për ata që nuk punonin?

Kamile Türbedar: Për ata që punonin për partinë, ata kishin rroga më të mëdha, dhe ata kishin privilegje, a din, *përparsi* siç thonë në shqip. Ata kishin. Ata punonin në poste më të mira. Sidoqoftë, ata me zanate, ata gjithnjë kanë bërë zanate. Ne po ashtu punonim, për shembull unë po ashtu punoja në dyqan të shtetit. Lejla dhe unë.

Ebru Süleyman: Do të thotë, flokëtaria ku ju punonit po ashtu ka qenë nën pronën e shtetit?

Kamile Türbedar: Nuk ka pasur dyqane private askund. Dyqani ynë ka qenë nën pronën e shtetit, dyqanet private u hapën më vonë. Dyqanet private. Më pas televizioni u hap nga ora 14:00, me prezantueset e lajmeve. Dikur unë i rregulloja, kështu ishte. Më pas e pranuan edhe vajzën time aty. Tash vajza ime ka dimplomuar në Ekonomik, ajo punon me kompjuterë, dhe ka fituar vendin në komunë, *ambleist*[6] i thonë.

Ebru Süleyman: Anëtare e asamblesë.

Kamile Türbedar: Po, ajo u bë anëtare e asamblesë. Ajo shkon në takime aty, ndonjëherë vjen këtu të më ndihmojë.

Ebru Süleyman: A të kujtohet kur je martuar?

Kamile Türbedar: Unë? Çfarë të të them, u martova kur i kisha 17 vjet. Ai ishte menaxheri im, u martova me të. Por nuk kemi kaluar, ai më kërkoi mua përmes vëllaut tim, atij i pëlqeja, ai ishte menaxheri im, por nuk kaluam.

Ebru Süleyman: A ishte ashtu në atë kohë?

Kamile Türbedar: Ai ishte i marrshëm, më duket e kishte për shkak të vëllaut tim. Atëherë, vajzat nuk kalonin, ai ishte shok i vëllaut dhe menaxheri im, dikur ai e pyeti vëllaun tim. Tani ai tha, "Po". Nëna

[6]Folësja përdor termin *ambleist* për të përshkruar anëtarin e asamblesë komunale.

ime nuk donte të më jipte sepse unë isha vetëm 17 vjeç. Ajo na detyroi të prisnim derisa i mbusha 18, ai më martoi pas gjashtë muajve.

Sidoqoftë, unë punoja. Ai punonte si berber, unë si flokëtare. Tani ai u bë menaxheri im, dhe kështu ishte.

Ebru Süleyman: Më pas i pari... fëmiu yt i parë.

Kamile Türbedar: Erol, tani Celal tani vajza ime Suzan. Unë linda tre fëmijë. Bashkëshorti im punoi si berber, ai ishte menaxheri im, ai më kërkoi martesë, vëllau më dha. Ai nuk ishte i keq, ai ishte i mirë, bashkëshorti im, falë Zotit. Kështu ishte. Ja ku je (qeshet).

Ebru Süleyman: Pra motra Kamile, a të kujtohet kur filloi… ju sapo më treguat që gratë dikur iu tregonin se çka po ndodh përreth, të gjitha lajmet do të qarkullonin përmes teje. Atëherë, kur filloi të komplikohet, për shembull kur studentët dolën në protesta, si ishte, a ka pasur tensione?

Kamile Türbedar: Unë isha në trajnim në Beograd atë ditë, ditën kur deshën t'ia dorëzojnë shtafetën Titos për herë të fundit. Për njëzet ditë. Mua më desh të kthehem dy ditë më herët sepse djali im po shkonte në ushtri. U thashë që më duhet të shkojë sepse djali po shkon, dhe shkova. Pastaj ata erdhën, unë i tregova menaxherit tim, ai u tregoi atyre të floktarisë, Shoqatës së Floktarëve në Beograd. Më pas ata erdhën natën, unë shkova në gjumë herët sepse duhesha të urdhëtoja për këtu [Prishtinë], djali më shkonte në ushtri. Poashtu isha duke e ndërtuar shtëpinë, më pas e rregulluam, unë jetoja në shtëpinë e vëllaut kur ndodhi… erdha nga Beogradu dhe një grua më tha mua, "*Vidiš, nisu mogli da daju štafetu*" [E shef, nuk kanë mundur t'ia dorëzojnë shtafetën] Titos. Mezi e kanë dorëzuar.

Ebru Süleyman: Ndonjë tollovi?

Kamile Türbedar: Unë i thashë asaj, "*Ja ne znam*" [Unë nuk e di] i thashë, "*ja idem iz Beograda*" [Unë po vi prej Beograd], kështu i thashë. Unë nuk i dhashë material; nuk e dija se çfarë po ndodh. Sidoqoftë, kur u ktheva më treguan.

Ebru Süleyman: Çka kishte ndodhur?

Kamile Türbedar: Ata mezi e kishin dorëzuar shtafetën.

Ebru Süleyman: Më pas u bë edhe më shumë…

Kamile Türbedar: Tani u ndërlikua shumë por ishte në rregull.

Ebru Süleyman: Çfarë bënin turqit kur këto tensione politike po zinin vend?

Kamile Türbedar: Jo, mirë ishte. Pastaj e hapën televizionin, ishte në gjuhën turke, shqipe dhe serbe. Lajmet në të trija gjuhët transmetoheshin në gjuhen turke poashtu. Turqve dhe shqiptarëve u dhanë të gjitha të drejtat, kështu që ishte mirë. Unë punoja për televizionin atëherë.

Ebru Süleyman: Po.

Kamile Türbedar: Këngëtarët vinin nga jashtë dhe më pas Erol Büyükburç erdhi nga Turqia me gruan e tij Emelin. Emri i gruas së tij [e dytë] poashtu ishte Emel. Ai e braktisi gruan e tij të parë, kjo ishte e dyta. Flokët e saj ishin natyrale, unë vetëm rregulloja fytyrën e saj me ca xixa. Sidoqoftë, ato katër gra që këndonin në kor, nuk i di emrat e tyre, por e di Emel Sayın. Kështu ishte.

Ebru Süleyman: Ju thatë që përveç Gërmisë, ju shkonit edhe në kinema, në Tauk Bahçe për argëtim.

Kamile Türbedar: Po, ne gjithnjë shkonim në Tauk Bahçe. Ndeznim zjarrin në Gërmi dhe pjeknim flija, kështu.

Ebru Süleyman: Më pasë në mahallë ju vizitonit njëri-tjetrin, a bënit edhe gjëra tjera? A shkonit në deti në pushime?

Kamile Türbedar: Ta them të vërtetën, unë shkoja sepse babai im kishte vdekur në luftë dhe ne dërgoheshim në deti çdo vit.

Ebru Süleyman: A ka shkuar secili?

Kamile Türbedar: Jo, por neve na dërgonin në pushime verore. Nëna ime erdhi të na shoh, së pari na dërguan në Luzhan mandej në Deçan, më vonë filluan të na dërgojnë në bregdet. Nëna ime nuk dinte të udhëtonte atëherë; më mungonte nëna. Nuk mund [udhëtoje] në Çakor, malet ishin shumë të mprehta dhe kishte teposhtëze. Tash mund të shkosh në Ulqin shumë shpejt, por atëherë ka qenë shumë vështirë.

Ebru Süleyman: Me çka shkonit atëherë, me vetura?

Kamile Türbedar: Me autobus. Tezja ime vinte, i thashë, "Eja teze të shkojmë në bregdet". Ajo tha, "Do të më merr fund jeta aty". Ai Çakorri, ato male të mëdha. Deri sa zbritje poshtë, e shihje një maje tjetër malore dhe ishte e tepërt. Shumë vështirë. Nuk kishte mënyrë, ishte sikur gjarpër {bën me dorë në formë gjarpëri}. Hyp lartë, e zbrit poshtë. Zot i madh, si shkonim atëherë, por rinia. Tezja ime u çmend, "Jo, nuk do të vijë më atje". Më pas rruga u rregullua; tash arrinë në Ulqin për një minut. Sa orë të duhet tash? Është afër tani. Sidoqoftë, atëherë ka qenë shumë vështirë të shkosha atje.

Ebru Süleyman: A shkonin njerëzit në vende të ndryshme të Jugosllavisë? Ke mundur të udhëtosh shumë më lehtë.

Kamile Türbedar: Po, po, natyrisht. Në Zagreb, Beograd, gjithsesi.

Ebru Süleyman: Ndërsa jashtë Jugosllavisë?

Kamile Türbedar: Shiko, kur mora vendin e parë atëherë kur për herë të parë u shfaq Kolestoni[7].

Ebru Süleyman: Po.

Kamile Türbedar: Unë e reklamoja Kolestonin, mora vendin e parë në Kosovë. Me stil flokësh dhe ngjyrë. Kolestoni, më pas më ftuan si mysafir atje në Lublanë. Tani shkova atje, më përshëndetshin sikur të isha mbretëreshë. Më treguan përreth fabrikën, më morën nga hoteli dhe ma tregonin qytetin. Nuk kishin më çfarë të bënin për mua, treguan aq shumë respekt.

Ebru Süleyman: Si ishte Lublana, shumë ndryshe nga këtu?

Kamile Türbedar: Po, ishin sllovenët, Sllovenia. Kur erdhi në fillim, për herë të parë, Kolestoni nuk kishte ekzistuar më herët. Përdornin hena për të ngjyrosur flokët dhe me një guri të cilin e shtypnin, ashtu ia bënin atëherë. Shtypnin gurin dhe përdornim ngjyrën e tij. Nuk ka pasur tjetër, ngjyrat e flokëve u shfaqën më vonë. Kolestoni ishte e para, tani Imedija dhe çka jo tjetër. Por dua të them, e mora vendin e parë me Koleston.

Ka qenë një grua Nina Kačunković, ajo ishte shumë e bukur. E pyeta, "*Hočeš da mi budeš manekenka?*" [A do të bëhesh modelja ime?] Ajo tha, "*Kako da ne*" [Si jo]. Tash unë i kisha frikat e mia si një e moshuar, dhe e pyes prapë, "*Nina nemoj da me ostaviš*" [Nina, mos më braktis] mos më braktis në momentin e fundit. Ia rregulloja flokët me Koleston ku ajo më tha, "*Ako me pitaš još jedan put neču da izađem*" [Nëse më pyet edhe një herë nuk të dal fare]. Sepse njerëzit në atë kohë ishin prapambetur, a din, nuk mund ta gjeje dikë të bëj pasarela të modës, apo jo? Ashtu ishte në atë kohë.

Pastaj shkuam në "Bozhur" dhe aty mora vendin e parë me Koleston. Ma dhanë një kuti të madhe kaq, ishte kaq e madhe {bën me e duar përshkruan madhësinë}. Nuk e dija çfarë ka në të, por ia dhashë modelës sime. Ta them të vërtetën kurrë nuk kam pyetur. Ajo ishte e bukur, ia dhashë asaj. Ngjyrosa flokët e saj me Koleston, ia rregullova stilin e flokëve për një ditë a dy, mora vendin e parë në Kosovë. Pastaj më ftuan në Lublanë, isha mysafire për një javë. Ma treguan fabrikën, u kujdesën për mua sikur të isha mbretëreshë. Katër-pesë prej tyre erdhën në mëngjes dhe ma treguan qytetin. Thashë vet me vete, kush jam unë të meritoj të gjitha këto? Sidoqoftë, kushdo që jam, unë isha meritore. Kështu shkoi edhe kjo kështu. Pastaj, punuam me Kolestonin, kështu…

[7] Firmë e ngjyrave për flokë e prodhuar në Sllloveni.

Ebru Süleyman: A ka pasur njerëz që kanë shkuar në vende tjera nga Jugosllavia, udhëtimi ka qenë relativisht i thjeshtë?

Kamile Türbedar: Më lejo të të tregoj, në kohën e Titos ne udhëtonim lehtë {prek mikrofonin me dorë}. *More po harroj* [Në shqip]. Udhëtonim lehtë. Po flas për kohën e Titos. Sidoqoftë, si kanë jetuar më parë unë nuk e di sepse kam qenë e vogël, por në kohën e Titos të gjithë kanë pasur. Secili ka mundur të arsimohet, fakultetin, ai i ka arsimuar të gjithë pa pagesë. Kështu ishte. Sigurimi shëndetsor, kishim gjithçka, po flas për kohën e Titos.

Ebru Süleyman: A vinin turistët këtu nga vendet e ndryshme të Jugosllavisë?

Kamile Türbedar: Natyrisht, vinin në Kosovë. Vinin dhe shpesh herë binin njerëz nga Beogradi, kishte shkëmbime. Dikur rregulloja flokët e gruas së Ilaz Kurteshit, ajo ishte myshterikja ime. Të gjitha gratë e këtyre ekzekutivëve, si Fadil Hoxha, Xhavit Nimani, Ilaz Kurteshi, e Asllan Fazliut poashtu i rregullonte te unë në sallon. Poashtu, Drita Dobroshi, ajo ishte kryesuese e Komitetit atëherë. Pastaj ishin këta serbët, Ana Šimić, e kush jo tjetër, të gjithë ishin myshterinjtë e mi, kështu. Unë rregulloja flokët e të gjithëve këtyre nga Ekzekutivi.

Ebru Süleyman: Atëherë, a ishin gratë dhe burrat më të barabartë apo pabarazia gjithnjë ka ekzistuar?

Kamile Türbedar: Të barabartë. Me Titon në pushtet ishim të barabartë. Kishte barazi. Në çdo aspekt ka qenë vllaznim-bashkim, kështu që. Kishte… sistemi ishte ndryshe.

Për Vitin e Ri shkonim, shkonim për ta pritur në “Bozhur” dhe më pas në “Grand”.

Më lejo të tregojë kur ia rregullova flokët Emel Sayın, ajo vinte për të kënduar. Atë e ftuan për Vitin e Ri. Dritat u ndalen, Emel Sayın hypi në skenë dhe dritat u ndalën, ajo iku menjëherë sepse kishte menduar që dikush do t’i bënte diçka. Më pas dritat u ndezën për më pak se një minut, por ajo ishte frikësuar. Nuk e di, si ia filloi të këndonte dritat u ndalën, nuk e di se çfarë ndodhi.

Ebru Süleyman: Ndonjë problem?

Kamile Türbedar: Problemi dikah tjetër, nuk është që dikush i ka ndalur me qëllim. Pastaj ajo iku. Më pas dritat u ndezën, ajo erdhi këndoi dhe kështu.

Ebru Süleyman: Më pas Jugosllavia përfundoi… në të ‘90-tat…

Kamile Türbedar: Më pas erdhi nga Shqipëria, Shqipëria, Vaçe Zela, Gaqo Çako, nuk e di, të gjithë këngëtarë shqipëtar. Më pas kemi pasur turne nëpër tërë Kosovën dhe në fund shkuam në Mal të Zi, u përshëndeta me ta në Mal të Zi, ata patën koncert aty, kënduan këngë dhe shkuan. Kështu ishin.

Ebru Süleyman: A të kujtohet kur më tregove, po supozoj kur u pensionove nga televizioni, kur po i afroheshim luftës, më pas lufta ndodhi dhe gjithçka ndryshoi?

Kamile Türbedar: Jo, gjithçka ndryshoi, po. Jo nuk kishte luftë kur kam punuar në televizion, ne ishim rehat.

Ebru Süleyman: Po, po, por ju u pensionuat dhe pastaj lufta kishte ndodhur.

Kamile Türbedar: Më pas e përfundova punën. U pensionova. Kur kjo ndryshoi, nuk e di, ne ikëm në Turqi. Unë shkova te vëllau im.

Ebru Süleyman: Si refugjate?

Kamile Türbedar: Ne qëndruam, qëndruam rreth gjashtë muaj dhe më pas u kthyem. Bashkëshorti im qëndroi këtu, të jem e sinqertë ai frikësohej.

Ebru Süleyman: Si çdonjëri prej nesh.

Kamile Türbedar: Si çdonjëri prej nesh, por ata nuk e lënduan bashkëshortin tim sepse ata kishin shkuar një ditë për të plaçkitur shtëpinë tonë, kur polici e pyet, "*Odakle ti ova tašna?*" [Prej nga e ke këtë çantë?] që e kishte parë aty. Shefqet Pllana kishte qenë me njërin, bashkëshorti i Ajtene Pllanës, ata ishin në Lublanë. Ata kishin pasur një takim atje dhe ata i kishin marrë atje dhe ai ia kishte dhënë bashkëshortit tim. "*Shefqet Plana mi je dao*" [Shefqet Pllana ma ka dhënë]. "*Koja kuča Shefqet*?" [Cila është shtëpia e Shefqetit?] Ai i ka thënë, "Aty ku ke dashur ta thyesh derën". Më pas ai polici nuk u ka lejuar tjerëve ta thejnë. Sepse ne të gjithë kishim ikur në Turqi. Më pas ata kishin shkuar te Shefqeti dhe ia kishin thyer derën dhe më pas bashkëshorti im më tha, "Ia rregullova derën me një drrasë". Kështu ishte. Ai nuk i kishte lejuar t'ua plaçkisnin shtëpinë. Shtëpia ime poashtu nuk ishte plaçkitur sepse ata po plaçkitnin në atë kohë.

Ebru Süleyman: Atëherë shumë njerëz…

Kamile Türbedar: Bashkëshorti im Samiu nuk kishte lejuar që shtëpia e Shefqet Pllanës të… Ai tha, "Kjo është e Shefqet Pllanës. Po, ne ishim së bashku". Ata ia kishin parë çantën, a po kupton? Tani ai e ka pyetur, "Ku e ke marrë këtë çantë?" "A e ke plaçkitur shtëpinë e Shefqet Pllanës, po?" Tani ai nuk i ka lejuar të tjerët të ia plaçkitin shtëpinë. Kështu. "Ne kemi qenë… ai ka qenë një njeri shumë i mirë, ne ishim në Lublana…" Kështu.

Ebru Süleyman: Më pas u kthyet?

Kamile Türbedar: Ne u kthyem, u kthyem pas luftës.

Ebru Süleyman: Më pas gjithçka ndryshoi.

Kamile Türbedar: Po. Unë isha aq e frikësuar sa që linda vajzën në Turqi. Isha e frikësuar, tmerruar, *korki daglari bekler*[8]. Suzan u lind në Turqi, kështu. E kisha një kusheri atje, ai ishte flokëtar atje dhe gruaja e tij poashtu ishte flokëtare. Djali i tij është mjek, mjeku Levent në Turqi. Vajza e tij poashtu qëndroi atje, ata [prindërit] vdiqën, kështu.

Ebru Süleyman: Tash kur shikon, kur shikon në të kaluarën a ka qenë jeta shumë më ndryshe?

Kamile Türbedar: Jeta është e mirë por e kaluara… është aq ndryshe. Sidoqoftë, nuk mund të ankohem sepse babai im vdiq në luftë, ata u kujdesën për ne dhe nuk mund të them asgjë tjetër. Nuk mund të them… ata u kujdesën për ne. Pajtoni, atëherë nuk kishte vetura; na binin qumësht pluhur, vezë pluhur, ashtu e quanin atëherë margarin, këto i binin me pajton. Nuk ka pasur asnjëgjë për të blerë në shitore. Tekstil për qepje të astareve, bluzave të brendshme, të brendshmeve. Dikur i sillnin materiale vëllaut tim që ai t'i qepte, ai ka qenë rrobaqepës. Kështu ishte, nuk ka pasur gjëra për të blerë në dyqane, asnjigjë.

Ebru Süleyman: Varfëria pas luftës?

Kamile Türbedar: Dëgjoje këtë, çorapet… kur çorapeve të holla u ikte vegëza, ne i dërgonim te një grua për t'ia kapur vegëzën. Ishte vështirë të bleje çorape të holla. Varfëria ishte e tillë, çfarë mund të të tregojë tjetër? Sot kemi gjithçka, qumësht e mjaltë me bollëk. Çfarë tjetër dëshiron që të të tregojë?

Ebru Süleyman: Nuk e di, nuk e di çfarë tjetër të të pyes, vetëm nëse ke diçka për të shtuar, diçka që të vie në mendje, çfarëdo që dëshironi. Nëse jo…

Kamile Türbedar: Më lejo të të tregojë, unë mora vendin e parë në Koleston këtu, ata më dërguan atje. Më trajtuan me shumë respekt.

Jovanka erdhi dy herë, ia rregullova flokët, kështu. Çfarë tjetër mund të të tregojë?

Ebru Süleyman: Më lejo të të pyes edhe diçka, cilat këngë i dëgjonit, kush dëgjohej më së shumti?

Kamile Türbedar: Qamili i Vogël në shqip dikur këndonte, "*Çu more Rexho*" [Në shqip].

---

[8]Tur.: *korki daglari bekler,* një thënje që ka kuptimin, frika e merr më të mirën nga njeriu.

Ebru Süleyman: Ju gratë cilat këngë i keni kënduar?

Kamile Türbedar: Dikur e sillnim Blind Meliha nga Vushtrria për darsma. Ajo këndonte në darsma. Kështu ishte. Ajo këndonte muzikë turke. Aty, aty ishin dy gra rome të cilat i binin defit në darsma. Ato këndonin në turqisht, kështu. Nuk e di nëse burrat kanë pasur muzikë, por gratë kishin në raste festive.

Ebru Süleyman: Ku qëndronin burrat?

Kamile Türbedar: Burrat rrinin ndamas.

Ebru Süleyman: Ku? Në përgjithësi në kafe?

Kamile Türbedar: Jo, jo, jo. Ata ishin në shtëpi. Fqinjët na i lëshonin shtëpitë e tyre; ishte ashtu në atë kohë. Fqinjët na i jipnin shtëpitë e tyre për burrat, dhe një tjetër e kishim për gratë.

Ebru Süleyman: Jo vetëm për darsma, por edhe për raste tjera.

Kamile Türbedar: Po, për raste të vdekjes po ashtu. Shtëpi tjetër për burrat, tjetër për gratë, ashtu ishte.

Ebru Süleyman: Në rregull motra Kamile. Faleminderit për gjithçka që na treguat!

Kamile Türbedar: Je e mirëseardhur. Çfarë tjetër të tregojë? Ishte një shtet, po të tregojë, ata dikur na dërgonin gjëra që ne të përparonim. Vëllezërit e mi nuk donin, sidoqoftë ata [shteti] deshtën të na rrisin neve sepse ne ishim pa babë, ai vdiq në luftë. Kishte respekt. Ne e kishim, rruga ishte e hapur për ne, a po kupton? Vetëm që ata nuk donin, njëri prej tyre u bë vozitës, tjetri operator i kinemasë, ai e kreu gjimnazin dhe u bë operator i kinemasë, lëshonte filma. Tjetri u bë vozitës, nëse e shikon atë tjetrin ai u bë bokser, kështu… sepse kishte përparësi për fëmijët e atyre që kishin vdekur në luftë, kishte shumë mundësi. Kështu ishte.

Ebru Süleyman: Faleminderit motra Kamile…

Kamile Türbedar: Je e mirëseardhur.

Ebru Süleyman: …për kohën tënde dhe tregimet e tua!

Kamile Türbedar: Çfarë të të them, faleminderit që erdhe, të tregova, kështu ishte.